

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT VLORE



Nr.571 I vendimit

Nr.1474 i aktit

V E N D I M
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Vlore, e perbere prej:
Kryesuese : Vasil Haxhahani
Anetar : Ilir Bezat
Anetar : Gjinovela Gaba

Sot ne daten 31.05.2012, mori ne shqyrtim ceshtjen nr.1474 qe I perket paleve:

PADITES : Shpk "Koha Ekspres" Lushnje

I PADITUR: Drejtoria Rajonale e Tatimeve, dega Fier.

ME PJESMARJEN e avokatit te shtetit, Mimoza Adhami.

OBJEKTI :

- Shpallja si absolutisht I pavlefshem I aktit te konstatimit nr.5673 date 16.04.2010,
- zhvleresimi I aktit te vleresimit tatimor nr.5370 date 16.06.2010,
- njoftim vleresimi per detyrimet tatimore me nr.6889 date 29.06.2010 sipas nenet 30/2 e 33 dhe 109/2 te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" dhe 324/b e 331 te K.Pr.Civile.

Gjykata e rrethit Gjyqsor Fier, me vendimin nr.262 date 16.02.2011 ka vendosur:

Anullimin e njoftim vleresimit per detyrimin tatimor nr.6889 date 29.06.2010 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Fier.

Kunder vendimit ka bere ankim ana e paditur qe ka kerkuar ndryshimin e tij dhe rrezimin e padise, duke parashtruar dhe shkaketsi :

- Vere punonjesja Luiza Kroi ka deklaruar se nuk ishte e siguruar dhe, sipas deklarimeve te saj dhe pas verifikimit nga punonjesis tane me telefon, prane

D.R.Tatimeve Fier,jemi informuar se njesia e sherbimit ishte e z.Gezim Kaja.

- Padrejtesisht Gjykata nuk ka marre parasysh pretendimet tona per bazueshmerine ne ligj te aktit te nxjerre ne adrese te anes paditese.

GJYKATA E APELIT VLORE

- Pasi degjoi relatorin V.Hanxhari,
- Avokaten e shtetit qe kerkoi ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e padise
- e si e bisedoi ceshtjen ne teresi,

VEREN

Se vendimi i gjykates se shkalles se pare eshte i drejte dhe i bazuar ne prova e ne ligj,prandaj dhe si i tille ai do te lihet ne fuqi.

Nga gjykimi i ceshtjes ka rezultuar se ana paditese "Koha Ekspres" shpk,me qender ne lagjen "Skender Libohova" ne qytetin e Lushnjes,eshte person juridik qe ushtron aktivitet tregetar ne fushen e transportit te udhetareve dhe te bagazheve,ne tregeti te mallrave industriale,ushqimore,elektroshtepiake,etj.

Por nga kontrolli i bere ne daten 16.04.2010,nga punonjesit e anes se paditur ne njesine e sherbimit bar-bufe,ne lagjen "Loni Dhamo",eshte konstatuar se punonjesja Luiza Kroj,nuk ishte e deklaruar ne organet Tatimore.Per kete,eshte mbajtur edhe akti i konstatimit me nr.56773.

Bazuar ne kete Akt,D.R.Tatimeve Fier ka nxjerre Njoftim Vleresimin per detyrimin tatimor nr.6889 date 29.06.2010,ku detyrohet ana paditese te paguaje shumen 125.885 leke.

Edhe Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve Tirane,qe ka shqyrtuar ankimin administrativ te anes paditese,eshte shprehur per lenien ne fuqi te Njoftimit te bere nga ana e paditur.

Gjykata e shkalles se pare,pasi ka cituar nje sere dispozitash proceduriale e materiale,ne perfundim ka konkluduar se,ndersa qendra e anes paditese shpk "Koha Ekspres" eshte ne lagjen "Skender Libohova" te qytetit te Lushnjes,bar-bufeja ku eshte gjetur punonjesja Luiza Kroj e pa deklaruar ne organet Tatimore, eshte ne lagjen "Loni Dhamo".Po keshtu,numri i identifikimit(NIPT) te anes paditese "Koha-Ekspres"shpk Lushnje eshte K340174021,ndersa ai(NIPT)i tatimpaguesit,qe eshte znj.Vera Kaja,eshte K341314274.Pra,edhe akti i konstatimit me nr.56773 date 16.04.2010 eshte mbajtur pikersisht prane subjektit te fundit tatimor qe nuk ka te beje asgje me anen paditese.

Sic me te drejte ka konkluduar Gjykata e shkalles se pare,punonjesit ne anes se paditur,para se te hartonin Aktin e konstatimit nr.56773 duhet te verifikonin ne sistemin elektronik te D.R.Tatimeve Fier,subjektin tatimor ku do te ushtrohet kontroll.

11/

Ne keto kushte, kur rezulton se Njoftim Vleresimi per detyrimin tatimor nr.6889 date 29.06.2010, nuk i perket anes paditese "Koha Ekspres" shpk Lushnje por nje personi tjetër, me te drejte eshte vendosur pranimi i padise.

Pretendimi i bere nga ana e paditur eshte i pambeshtetur ne asnje argument ligjor qe te rrezoje argumentet e paraqitura ne arsyetimin e vendimit te Gjykates.

Pavaresisht deklarimeve te punonjeses se gjetur ne vendin e punes e per te cilen eshte pretenduar se ka qene e padeklaruar dhe e pa siguruar ne skemen e sigurimeve shpëtorore, punonjesisht e anes se paditur kane detyrimin qe te jene te sigurt ligjerisht, per numrin e identifikimit dhe adresen e subjektit qe inspektohet. Kete "siguri" ata nuk mund ta krijojne me ane te telefonatave apo informatave te marra nga personat qe gjejne gjate kontrollit te tyre.

PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit, bazuar ne nenin 466/a te K.Pr.Civile

VENDOSI


Lenien ne fuqi te vendimit nr.262 date 16.02.2011 te Gjykates se rrethit gjyqsor Fier.

Vlore, me 31.05.2012

Anetar
Gjinovefa Gaba



Anetar
Iliba Bezati



Kryesues
Vasil Hanxhari



VERTETOHET
Njësia me Origjinalin
KANCELARE

Frida Gani

